



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Datë 20.06.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E FUNKSIONIMIT TË QENDRËS “FUQIZOJMË KOMUNITETIN” ME MBËSHTETJEN NGA PROGRAMI I FONDIT SOCIAL TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITET 2025-2027 DHE BUXHETI I BASHKISË Durrës.

Baza ligjore:

Ligji nr.139 dt.17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Deklarata e Përgjithshme të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, ligji nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, VKM nr. 658, datë 17.10.2005 “Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”, Udhëzim nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Qendrat Komunitare Shumëdisiplinore”, Vendim i Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027”, Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.95, datë 28.10.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë”, Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Bashkisë dhe UNDP Shqipëri nr.2327 prot., datë 01.03.2023, Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 605, datë 15.01.2025 të lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shërbimit Social Shtetëror “Për zbatimin e projektit “Shërbim i integruar për fuqizimin e individëve në nevojë”.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e funksionimit të Qendrës “Fuqizojmë Komunitetin” me një strukturë prej 15 punonjësish.
2. Miratimin e fondit prej 10,278,097 lekë për financimin e shpenzimeve të personelit për Qendrën “Fuqizojmë Komunitetin” për vitin 2025.

3. Miratimin e përdorimit të fondit prej 6,610,177 lekë që financohet nga Fondi Social i buxhetit të shtetit për financimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore për 7 punonjës.
4. Miratimin e fondit prej 3,667,920 lekë që do të financohet nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 që do të përdoret për financimin e shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore) për 8 punonjës, si më poshtë:

Kodi Njesisë shpenzuese	Njësia shpenzuese	Program buxhetor	Llogaria ekonomike	Fondi
2107017	Qendra Ditore të Moshuarve	10430	600	3,143,050
2107017	Qendra Ditore të Moshuarve	10430	601	524,870

5. Veprimet financiare të kësaj qendre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të të Moshuarve.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fondi Social i buxhetit të shtetit për financimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore si dhe fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, u mbledhë më datë 20.06.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 3 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Bashkia e Durrës, Komiteti i Përbashkët i Përhershëm i Përkohshëm.
PNV dhe UNDP kanë marrë pjesë në këtë.
Organizatori më i mirë i kësaj shërbimi të mirë është PNV
i cili ka detyrën të vlerësojë këtë shërbim.

